

12 Bankat, shembull për investime në komunitet

14 Mbi 1.2 miliardë euro kredi të reja

IBANK

Janar 2019 | Nr. 18 - Gratis



Hamza: 1600 vende të reja pune vetëm nga kreditë e garantuara bankare

FAQE 07

MILIONAT E BANKAVE NË KOMUNITET

Fehmi Mehmeti, guvernator i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), ka bërë të ditur se investimet e bankave komerciale përgjatë tre viteve të fundit në komunitet, përkatësisht 2016, 2017, 2018, arrijnë shumën e përgjithshme prej 1.2 milion euro. **FAQE 03**

Bankat e fuqizojnë shoqërinë

PETRIT BALIJA

FAQE 02



Bankat e fuqizojnë shoqërinë



PETRIT BALIJA

Përveç kontributit të madh në zhvillim ekonomik të vendit përmes aktiviteteve të financimit dhe shërbimeve të pagësive, institucionet bankare i kushtojnë rëndësi të veçantë edhe përgjegjësisë sociale. Përgjegjësia sociale është një koncept shumë i rëndësishëm për institucionet bankare ku gërshetohen shumë tema, si: të drejtat e njeriut, qeverisja korporative, shëndeti dhe siguria, efektet mjedisore, kushtet e punës, edukimi dhe kontributi në zhvillimin ekonomik etj. Qëllimi parësor është që ta nxisë ndryshimin drejt qëndrueshmërisë së shoqërisë në të cilën vepron dhe afaron si biznes komercial. Prandaj bankat komerciale të Kosovës vazhdimisht janë duke investuar në mbështetje të komunitetit. Megjithëse nevojat janë të shumta dhe çdo shumë e investuar mund të duket simbolike në raport me këto nevoja, përfitimet të cilat i ka komuniteti nga investimet e bankave janë frytdhënëse dhe kanë një impakt pozitiv në shoqërinë tonë.

Sektori bankar mbështet kauza dhe aktivitete të ndryshme përfshirë ato sociale, kulturore, arsimore, sportive, shëndet-



Qëllimi parësor është që ta nxisë ndryshimin drejt qëndrueshmërisë së shoqërisë në të cilën vepron dhe afaron si biznes komercial. Prandaj bankat komerciale të Kosovës vazhdimisht janë duke investuar në mbështetje të komunitetit.

AUTORI ËSHTË
DREJTOR I
SHOQATES SË
BANKAVE TË
KOSOVËS

tësore, ambientale, etj. Fokusi kryesor i aktiviteteve më të rëndësishme të përgjegjësisë sociale të bankave në vitin 2018 ishin si në vijim, mbështetja financiare për:

KLUBET SPORTIVE TË KOSOVËS,

AKTIVITETEVE KULTURORE PËR FËMIJËT ME NEVOJA TË VEÇANTA,

PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS NË

INSTITUCIONET SHËNDETËSORE SHTETËRORE,

AKTIVITETET EDUKATIVE ARSIMORE,

MBLEDHJA E FONDEVE PËR QËLLIME BAMIRËSE.

Sektori bankar ka kontribuar edhe në edukimin financiar përmes fushatave informuese si dhe aktiviteteve sektoriale në sistemin arsimor, përmes Shoqatës së Bankave të Kosovës ku janë shënuar Java e Parasë, Dita e Kursimeve, Fushata për reduktimin e parasë së gatshme dhe informalitetit, konferenca dhe seminare, etj. Përgjegjësia sociale do të vazhdojë të mbetet prioritet i sektorit bankar edhe në të ardhmen duke rritur edhe më shumë angazhimet e përbashkëta në këtë drejtim. Shumica e bankave janë edhe anëtare të rrjetit të përgjegjësisë sociale të Kosovës CSR, ku vazhdojnë të japin kontributin e tyre të rëndësishëm. Mbetet që të gjithë të angazhohemi edhe më shumë që t'i koordinojmë më mirë të gjitha aktivitetet individuale në misionet dhe agjenda të përbashkëta më qëllime më të qarta dhe bashkimin e forcave të të gjithë akterëve të sektorit privat për ta fuqizuar shoqërinë në Kosovë.



Milionat e bankave në komunitet

Fehmi Mehmeti, guvernator i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), ka bërë të ditur se investimet e bankave komerciale përgjatë tre viteve të fundit në komunitet, përkatësisht 2016, 2017, 2018, arrijnë shumën e përgjithshme prej 1.2 milion euro.

Fehmi Berisha, 55 vjeç, çdo mëngjes i sillet rreth e qark parkut të lagjes “Dardania” në Prishtinë. Në pamundësi që të shkojë çdo ditë në parkun e Gërmisë, Fehmiu gjatë muajve të verës zgjohet në orën 6 në mëngjes dhe për dy orë sillet rreth e rrotull këtij parku, përderisa edhe gjatë dimrit, kur temperaturat janë të ulëta, ai nuk e harron këtë “ritual”. “Tashmë kur bie borë dhe temperaturat janë në minus, çdo ditë zgjohem në orën 7 të mëngjesit dhe për një orë eci rreth parkut. Kjo gjë më ndihmon shumë për

shëndet”, tregon Fehmiu, teksa përhëndetet me disa fqinjë të lagjes “Dardania”, të cilët kalonin përmes këtij parku ku është edhe Sheshi “Xhevë Lladrovci”.

Ai tregon se nuk ka më shumë se katër vite që ky park ishte inaguruar nga Komuna e Prishtinës, përderisa investimet për rregullimin e tij i kishte bërë një bankë komerciale kosovare, por, sipas tij, banorët e lagjes nuk janë treguar shumë të kujdesshëm me këtë hapësirë të paktë gjelbëruese në kryeqytet, pasi që ulëset dhe

**Parku i Lagjes “Dardania” në Prishtinë
është shndërruar në një vend të
rehatshëm për qëndrim dhe shfrytëzim
për banorët që banojnë përreth**

**Në këtë park, njëra nga bankat
komerciale kishte investuar rreth
60 mijë euro**





**DOKU
FEST**
International Documentary
and Short Film Festival

shportat e bërlllogut janë dëmtuar dukshëm.

“Ka qenë një park shumë i mirë, u bë një hapësirë e madhe gjelbëruese, u mbollën shumë drunj, u vendosën ulëset për të pushuar, shportat e bërlllogut, por fëmijët dhe disa banorë të pakujdesshëm e kanë dëmtuar dukshëm Parkun. Në Prishtinë kemi shumë beton dhe pak parqe, prandaj duhet t’i ruajmë si ‘sytë e ballit’, tregon ai.

Përndryshe, në korrik të vitit 214 ishte inauguruar nga Komuna e Prishtinës Parku i Lagjes “Dardania”, me ç’rast më shumë se 9500 metra katrorë sipërfaqe publike ishin gjelbëruar dhe pajisur me ulëse dhe shporta, duke e shndërruar këtë hapësirë në park të rehatshëm për qëndrim dhe shfrytëzim për banorët që barojnë përreth. Në këtë park, njëra nga bankat komerciale kishte investuar rreth 60 mijë euro, duke i rritur hapësirat e gjelbra publike, si dhe duke kontribuar për një mjedis të pastër.

INVESTIMET E BANKAVE NË KOMUNITET

Si ky projekt në lagjen “Dardania” të Prishtinës, bankat komerciale të Kosovës kanë inves-

Bankat komerciale ose janë bashkë-financuese, ose financuese të vetme të ngjarjeve më të mëdha kulturore, apo projekte të ndryshme në vend si: festivali Dokufest, Shoqata Down Syndrome Kosova, Shoqata Ndërkomunale e të Vërbërve, Klinika Gjinekologjike në regjione të Kosovës, Galeria Kombëtare, etj.

tuar për komunitetin edhe në shumë projekte tjera në nivel të vendit, në kuadër të përgjegjësisive të tyre korporative. Fehmi Mehmeti, guvernator i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), ka bërë të ditur se investimet e bankave komerciale në komunitet përgjatë tre viteve të fundit, përkatësisht 2016, 2017, 2018, arrijnë shumën e përgjithshme prej 1.2 milion euro. “Investimet e bankave komerciale gjatë tre viteve të fundit kanë qenë në projekte të ndryshme të Komunave të Kosovës në shumën prej rreth 1.2 milionë euro”, ka bërë të ditur Mehmeti. Sipas tij, çdo banke komerciale, pavërsisht se në cilin qytet operon, në kuadër të politikave të veta operative ka edhe përgjegjësinë e tyre korporative, përkatësisht investimin në komunitet.

“Bankat komerciale në vazhdimësi janë duke investuar në komunitet, në kuadër të përgjegjësisive të tyre korporative”. Ai ka shtuar se bankat ose janë bashkë-financuese, apo edhe financuese të vetme të ngjarjeve më të mëdha kulturore, apo projekte të ndryshme në vend si: Dokufest, shoqata “Down Syndrome Kosova”, Shoqata Ndërkomunale e të Vërbërve, Klinikën Gjinekologjike në regjione të

1.200.000€

kanë investuar bankat komerciale të Kosovë në projekte të ndryshme për komunitetin përgjatë tre viteve të fundit, bëjnë të ditur zyrtarët e Bankës Qendrore të Kosovës.



Kosovës, Galerinë Kombëtare, etj.

PRAKTIKËN E BANKAVE PO E NDJEKIN EDHE BIZNESET TJERA

Përfaqësuesit e bizneseve në Kosovë thonë se bankat komerciale një pjesë të fitimeve vazhdimisht e investojnë edhe në komunitet.

Berat Rukiqi, kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), thotë se sistemi bankar në vend, krahas rolit të tij pozitiv në zhvillimin e sektorit të ekonomisë, sipas tij, në vazhdimësi ka pasur edhe një rol shumë të rëndësishëm në aspektin social, pasi që në vazhdimësi një pjesë e përfitimeve të tyre e kanë investuar në projekte që i kanë shërbyer komunitetit. “Është një e mirë që po ndodh tash, se praktikën e bankave së fundi kanë filluar ta ndjekin edhe kompanitë tjera që operojnë në vendin tonë, ku një pjesë të mirë të kapitalit të tyre po e investojnë në vendin ku ata po zhvillojnë biznese”, ka thënë Rukiqi. Por, sipas tij, sido që të jetë, bankat në Kosovë janë pioniere të financimit të shumë projekteve të institucioneve që kanë shumë nevojë, siç është: Shoqata e Personave të Prekur me Sindromën Down, por edhe institucione tjera të natyrës së njëjtë që kanë shumë nevojë për përkrahjen e shoqërisë. Rukiqi thotë se investimet e bankave janë vërejtur edhe në projekte tjera publike siç është: ndërtimi i parqeve të ndryshme, të cilat janë në funksion të gjithë qytetareve të Kosovës.

INVESTIMET NË KOMUNITET, PRAKTIKË E SHTETEVE TË ZHVILLUARA

Halit Shabani, dekan i Fakultetit të Biznesit në Universitetin Publik “Haxhi Zeka” në Pejë, thotë se përkujdesi që është dashur dhe duhet ta bëjë shteti ndaj komuniteteve që kanë nevojë më të madhe për ndihmë financiare në Kosovë po e bëjnë bizneset pri-

“Bankat komerciale në vazhdimësi janë duke investuar në komunitet, në kuadër të përgjegjësive të tyre të korporatave”, thotë Fehmi Mehmeti, guvernator i BQK-së

vate. “Veprimi i bankave është për t’u përshëndetur, pasi që ato përmes donacioneve në vazhdimësi kanë ndihmuar dhe po ndihmojnë një pjesë të shoqërisë që ka nevojë shumë për ndihmën tonë. Në kushte dhe rrethana normale këtë përkujdesje është dashur ta bëjë shteti, por kur këta të fundit po i lënë anash, janë drejtutuesit e bankave që përkujdesen për njerëzit që kanë shumë nevojë për ndihmë”, ka thënë Shabani. Sipas tij, këtë shembull të mirë të sektorit bankar duhet ta ndjekin edhe kompanitë tjera të mëdha në Kosovë, të cilat brenda vitit arrijnë të krijojnë profit të lartë. “Investimi në komunitet, në vendin ku biznesi zhvillon aktivitetin e vet, janë praktike edhe e shteteve të zhvilluara”, ka thënë më tutje Halit Shabani.

Përndryshe, përveç projekteve për komunitetin, bankat komerciale, nëpërmjet kreditimit për bizneset vendore, po ndikojnë edhe në rritjen e prodhimit vendor, njëkohësisht uljen e importeve dhe hapjen e vendeve të reja të punës.

Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka bërë të ditur se në periudhën e fundit, vërehet një rritje më e madhe për sektorët që konsiderohen me potencial më të madh për të gjeneruar rritje ekonomike siç janë: sektori i prodhimit dhe sektori i bujqësisë, gjë që, sipas tij, paraqet një zhvillim shumë të favorshëm për ekonominë e vendit. “Këta sektorë në përgjithësi karakterizohen me një përfshirje më të madhe të fuqisë punëtore, prandaj rritja e kreditimit të tyre mund të ketë një ndikim më të madh në krijimin e vendeve të reja të punës dhe, rrjedhimisht, në reduktimin e papunësisë. Sipas informatave të fundit, vetëm nga kreditë e garantuara nga Fondit Kosovar për Garanci Kreditore vlerësohet se janë krijuar rreth 1,600 vende të reja pune”, ka bërë të ditur Hamza.



HAMZA: 1600 VENDE TË REJA PUNE VETËM NGA KREDITË E GARANTUARA BANKARE

Ministri i Financave, Bedri Hamza, është shprehur se nga kreditimi bankar gjatë vitit 2018 rritjen më të madhe e ka shënuar sektori i prodhimtarisë dhe bujqësisë, gjë që, sipas tij, paraqet një zhvillim të favorshëm për ekonominë e Kosovës. Ai ka bërë të ditur se vetëm nga kreditë e garantuara nga Fondit Kosovar për Garanci Kreditore vlerësohet se janë krijuar rreth 1,600 vende të reja pune.

Rënia e kredive joperformuese, konkurrenca gjithnjë në rritje të sektorit bankar dhe rritja e efikasitetit të këtij sektori, lehtësimet e zbatimit të kontratave, si dhe përmirësimet tjera në ambientin e biznesit etj., konsideroj se paraqesin përmirësim të rëndësishëm të kushteve të nevojshme për të pasur rënie të mëtutjeshme të normave të interesit në kredi gjatë vitit 2019. Kështu thotë në një intervistë ministri i Financave, Bedri Hamza, i cili vlerëson se sektori bankar vazhdon të ketë performancë pozitive, në të gjithë treguesit e tij. Ministri i Financave në Qeverinë e Kosovës e ka

theksuar faktin se edhe gjatë vitit 2018 kreditimi i bizneseve nga ana e sektorit bankar në vazhdimësi ka shënuar rritje, ku siç thotë ai, vërehet një rritje më e madhe për sektorët që konsiderohen me potencial më të madh për të gjeneruar rritje ekonomike siç janë: sektori i prodhimtarisë dhe sektori i bujqësisë, gjë që paraqet një zhvillim shumë të favorshëm për ekonominë e vendit. “Këta sektorë në përgjithësi karakterizohen me një përfshirje më të madhe të fuqisë punëtore, prandaj rritja e kreditimit të tyre mund të ketë një ndikim më të madh në krijimin e vendeve të reja

11%

KANË SHËNUAR RITJE VJETORE KREDITË BANKARE.

2.8%

KA RËNË NORMA E KREDIVE JOPERFORMUESE TË SEKTORIT BANKAR TË KOSOVËS.

2.7 MILIARDË €

KA ARRITUR VLERA E PËRGJITHSHME E KREDIVE BANKARE.

të punës dhe, rrjedhimisht, në reduktimin e papunësisë. Sipas informatave të fundit, vetëm nga kreditë e garantuara nga Fondit Kosovari për Garanci Kreditore vlerësohet se janë krijuar rreth 1,600 vende të reja pune”, bënë të ditur Hamza.

Në këtë intervistë ai ka folur edhe për investimet e bankave komerciale në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës, ku, sipas tij, vlera e përgjithshme e këtyre investimeve ka kaluar shumë prej 222 milionë euro.

BANKAT PO E RRISIN MBËSHTETJEN PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK TË KOSOVËS

Z. Hamza, si e vlerësoni performancën e sektorit bankar gjatë vitit 2018 dhe sa po kontribuon ky sektor në zhvillimin ekonomik të Kosovës?

Hamza: Bazuar në informatat e publikuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK), sektori bankar vazhdon të ketë performancë pozitive, në të gjithë treguesit e tij. Ky sektor gjatë kësaj periudhe

“

Rënia e kredive joperformuese, konkurrenca gjithnjë në rritje të sektorit bankar dhe rritja e efikasitetit të këtij sektori, lehtësimet e zbatimit të kontratave, si dhe përmirësimet tjera në ambientin e biznesit konsideroj se paraqesin përmirësim të rëndësishëm të kushteve të nevojshme për të pasur rënie të mëtutjeshme të normave të interesit në kredi

është karakterizuar me rritje të aktivitetit kreditues, derisa indikatorët kyç të shëndetit financiar vazhdojnë të jenë në pajtim me kërkesa ligjore. Vlera e gjithsej kredive në këtë periudhë ishte rreth 2.7 miliardë euro, me një rritje vjetore mbi 11%, që nënkupton rritje të mbështetjes së këtij sektori për zhvillimin ekonomik të vendit. Pjesa më e madhe e kredive të lëshuara nga sektori bankar janë kredi të lëshuara për bizneset, gjë që tregon kontributin e rëndësishëm të sektorit bankar për zhvillimin e bizneseve, rritjen e punësimit dhe, rrjedhimisht, për zhvillimin ekonomik të vendit.

1.7 MILIARDË EURO KREDI PËR BIZNESET

Kosova vazhdon të jetë shumë e varur nga mallrat e importit. Sa po arrijnë t'i zhvillojnë kapacitetet prodhuese bizneset vendore nëpërmjet financimeve bankare?

Hamza: Kreditimi i bizneseve nga ana e sektorit bankar në vazhdimësi ka shënuar rritje. Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2018,



VENDE TË REJA TË PUNËS VLERËSOHET SE JANË KRIJUAR VETËM NGA KREDITË E GARANTUARA NGA FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE.

1.7 MILIARDË €

APO 63%

E GJITHSEJ PORTOFOLIT KREDITOR TË SEKTORIT BANKAR, KA ARRITUR VLERA E PËRGJITHSHME E KREDIVE TË LËSHUARA PËR BIZNESET NË TRE MUJORIN E TRETË TË VITIT 2018.

vlera e kredive të lëshuara për bizneset arriti në 1.7 miliardë euro apo 63% e gjithsej portofolit kreditor të sektorit bankar. Ndër sektorët me rritjen më të madhe të kredive të pranura ishin sektori prodhues dhe ai i bujqësisë. Këto zhvillime në masë të madhe rezultojnë nga lehtësimet e aplikuara nga ana e sektorit bankar, por rëndësi të madhe ka pasur edhe krijimi i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, i cili ka për qëllim kryesor lehtësimin e qasjes në financim bankar për sektorët që aktualisht kanë qasje më të ulët në kreditë bankare. Qasja më e mirë në financim bankar sigurisht se pritet të ketë ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e kapaciteteve prodhuese për bizneset vendore.

A shihni një fokus më të madh të bankave për t'i kredituar bizneset vendore dhe a po ndikon kjo edhe në rritjen e punësimit, përpos prodhimit vendor?

Hamza: Vlen të theksohet se portofoli kreditor i sektorit bankar pothuajse në tërësi përbëhet nga kreditë e lëshuara për bizneset që operojnë në Kosovë, prandaj çdo rritje e

kreditimit nënkupton rritje të financimit për bizneset vendore. Në periudhën e fundit, vërehet një rritje më e madhe për sektorët që konsiderohen me potencial më të madh për të gjeneruar rritje ekonomike siç janë: sektori i prodhimit dhe sektori i bujqësisë, gjë që paraqet një zhvillim shumë të favorshëm për ekonominë e vendit. Këta sektorë në përgjithësi karakterizohen me një përfshirje më të madhe të fuqisë punëtore, prandaj rritja e kreditimit të tyre mund të ketë një ndikim më të madh në krijimin e vendeve të reja të punës dhe, rrjedhimisht, në reduktimin e papunësisë. Sipas informatave të fundit, vetëm nga kreditë e garantuara nga Fondit Kosovar për Garanci Kreditore vlerësohet se janë krijuar rreth 1,600 vende të reja pune. Megjithatë, akoma nevojitet angazhim më i madh i të gjithë akterëve me qëllim të rritjes dhe zhvillimit të prodhimit, rritjes së produktivitetit, si dhe krijimit të kushteve për qasje më të madhe të produkteve tona në tregjet e jashtme në mënyrë që të ndikohet në hapje të vendeve të reja pune dhe zhvillim më të madh ekonomik në vend.

Mbi 3.2 miliardë euro kanë arritur depozitat e qytetarëve në bankat vendore, mjete këto më shumë se buxheti vjetor i Kosovës. Sa janë të sigurtat paratë e qytetarëve në banka dhe a ka rrezik të përsëritet situata e vitit 2007 kur me mbylljen e një banke komerciale ishin rrezikuar depozitat e qytetarëve?

Hamza: Sektori bankar në Kosovë vazhdon të jetë i qëndrueshëm, me nivel të kënaqshëm të likuiditetit, mjaftueshëm i kapitalizuar, profitabil dhe me cilësi shumë të mirë të portofolit kreditor. Bazuar në këta tregues kyç të shëndetit financiar, si dhe në performancën pozitive të sektorit bankar, vlerësoj se bankat janë në gjendje të përballojnë tronditjet e mundshme në mjedisin ekonomik dhe të sigurojnë që depozitat e qytetarëve të jenë të sigurt dhe në asnjë mënyrë të rrezikuara. Qëndrueshmëria e lartë e sektorit bankar të Kosovës është dëshmuar edhe gjatë krizës së fundit globale, kur bankat që operojnë në Kosovë nuk treguan asnjë shenjë të tronditjes nga kushtet e pafavorshme në ekonominë globale.

Hamza: Sektori bankar në Kosovë vazhdon të jetë i qëndrueshëm, me nivel të kënaqshëm të likuiditetit, mjaftueshëm i kapitalizuar, profitabil dhe me cilësi shumë të mirë të portofolit kreditor. Bazuar në këta tregues kyç të shëndetit financiar, si dhe në performancën pozitive të sektorit bankar, vlerësoj se bankat janë në gjendje të përballojnë tronditjet e mundshme në mjedisin ekonomik dhe të sigurojnë që depozitat e qytetarëve të jenë të sigurta dhe në asnjë mënyrë të rrezikuara



Sa është shuma e përgjithshme e investimeve të bankave komerciale në bono të thesarit dhe a janë në rritje investimet e tilla?

Hamza: Zhvillimi dhe avancimi i tregut të brendshëm të Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës, si burim i financimit të projekteve afatshkurtra dhe kapitale në vend, është realizuar me hyrjen në fuqi të Ligjit për Borxhin Publik në Kosovë në Janar të vitit 2010, me ç' rast u krijua mundësia e qasjes së Qeverisë së Republikës së Kosovës në borxhin publik. Rrjedhimisht, në janar të vitit 2012 është shpallur ankandi i parë i letrave me vlerë, kur për të herë të parë në Kosovë filloi emetimi i bonove të thesarit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përmes ankandeve publike, të cilat organizohen dhe monitorohen nga ana e BQK-së. Në tremujorin e tretë të këtij viti, gjithsej vlera e përgjithshme e investimeve nga ana e bankave komerciale në lettrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës ishte 222.1 milionë euro. Duke pasur parasysh zhvillimin dhe rritjen e vazhdueshme të tregut të letrave

me vlerë, edhe pjesëmarrja e bankave në këtë treg është rritur në vazhdimësi.

Kosova është vendi që ka përqindjen më të ulët në rajon të kredive joperformuese. Çka përdikon që kreditë e tilla në Kosovë të qëndrojnë në nivel më të ulët se 3%?

Hamza: Sektori bankar i Kosovës në vazhdimësi është karakterizuar me një cilësi shumë të mirë të portofolit kreditor, e cila paraqet një shtyllë shumë të rëndësishme të stabilitetit të përgjithshëm të sektorit bankar të Kosovës. Në shtator 2018, norma e kredive joperformuese në këtë sektor ishte 2.8%. Faktorët që kanë kontribuar në cilësinë e mirë të portofolit kreditor mund të jenë të shumtë, por ndër më të rëndësishmit konsideroj se janë stabiliteti makroekonomik, zhvillimet legjislativ gjatë viteve të fundit, siç është rasti me përmbaruesit privat që kanë lehtësuar ekzekutimin e kolateralit dhe zbatimin e kontratave, mbikëqyrja e kujdesshme nga ana e BQK-së, menaxhimi

adekuat i rreziqeve bankare nga ana e bankave, si dhe sjellja e përgjegjshme e qytetarëve të Republikës së Kosovës në përmbushjen e obligimeve të tyre kontraktuale kundrejt bankave.

Viti 2018 është karakterizuar me norma më të ulëta të interesit në kredi, si dhe zvogëlim të përqindjes së kredive joperformuese. A mund të pritet rënie të kamatave të kredive edhe në vitin 2019?

Hamza: Rënia e kredive joperformuese, konkurrenca gjithnjë në rritje të sektorit bankar dhe rritja e efikasitetit të këtij sektori, lehtësimet e zbatimit të kontratave, si dhe përmirësimet tjera në ambientin e biznesit konsideroj se paraqesin përmirësim të rëndësishëm të kushteve të nevojshme për të pasur rënie të mëtutjeshme të normave të interesit në kredi. Një zhvillim i tillë do të ishte shumë i favorshëm për rritjen e mëtejme të mbështetjes së sektorit bankar ndaj zhvillimit ekonomik të vendit.

Rreth 480 milionë euro depozita të reja

Në sektorin bankar të Kosovës depozitat e reja kanë arritur në 479 milionë euro gjatë periudhës janar-nëntor 2018, bëhet e ditur në raportet e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), përderisa në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kanë shënuar rritje për 73.4 milionë euro.

Bazuar në të dhëna zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) shihet se në nëntor të vitit 2018 shuma e mjeteve të depozituara në banka ka arritur vlerën 31.8 milionë euro, nga 31.1 milionë euro sa kanë qenë gjatë muajit nëntor të vitit paraprak. Po ashtu, gjatë muajit tetor të vitit 2018, shuma e mjeteve të depozituara në bankat komerciale që operojnë në Kosovë ka arritur në 38.2 milionë euro, nga 30.4 milionë euro sa kanë qenë në tetor të vitit 2017. Ndërsa gjatë muajit shtator të po kësaj periudhe, në bankat komerciale janë depozituar 43.3 milionë euro, nga 40.9 sa ishin depozituar në muajin e njëjtë të vitit paraprak. Pra, gjatë muajit shtator në banka janë deponuar 43.3 milionë euro, apo 2,4 milionë euro më

shumë se sa në shtatorin e vitit 2017, derisa gjatë muajit gusht të vitit të kaluar shuma e mjeteve të depozituara ka arritur rekord në 88.9 milionë euro, nga 70.5 milionë sa ishin në muajin e njëjtë të vitit paraprak. Edhe gjatë muajit korrik 2018 ka pasur rritje të depozitave në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Gjatë këtij muaji në banka janë depozituar 68.8 milionë euro, nga 59.2 sa ishin në korrik të vitit 2017. “Gjatë muajit qershor të vitit 2018 në banka janë depozituar 22.5 milionë euro, gjatë muajit maj 37 milionë euro, gjatë muajit prill 33.4 milionë euro, gjatë muajit mars 40.6 milionë euro, gjatë muajit shkurt 33.6 milionë euro, si dhe gjatë muajit janar 40.9 milionë euro”, thuhet mes tjerash në raportin e fundit të BQK-së. Derisa gjatë qershorit të vitit 2017, në banka janë depozituar 27.1 milionë euro, gjatë muajit maj 24.8 milionë euro, gjatë muajit prill 26.1 milionë euro, gjatë muajit mars 29.2 milionë euro, gjatë muajit shkurt 29.2 milionë euro si dhe gjatë muajit janar 37 milionë euro.

Depozitat e reja në periudhën janar-nëntor 2018

	2018	2017	Diferenca
Janar	40,9	37,0	+ 3,9
Shkurt	33,6	29,2	+ 4,4
Mars	40,6	29,2	+ 11,4
Prill	33,4	26,1	+ 7,3
Maj	37,0	24,8	+12,2
Qershor	22,5	27,1	- 4,6
Korrik	68,8	59,2	+ 9,6
Gusht	88,9	70,5	+ 18,4
Shtator	43,3	40,9	+ 2,4
Tetor	38,2	30,4	+ 7,8
Nëntor	31,8	31,1	+ 0,7
	479,0	405,6	+73,4



Bankat, shembull për investime në komunitet

Sektori bankar i Kosovës është njëri prej sektorëve ku më së shumti zbatohen parimet bazë të përgjegjësisë korporatave. Kështu ka theksuar Linda Tahiri-Rukiqi, drejtore e Rrjetit për Përgjegjësi Shoqërore Korporative (CSR Kosova), duke shtuar se edhe bizneset tjera duhet ta ndjekin këtë shembull të bankave.

Drejtoresha e Rrjetit CSR Kosova ka bërë të ditur se ky rrjet është platformë e kompanive dhe organizatave të përgjegjshme ndaj shoqërisë dhe ka për qëllim primar kontributin në zhvillim të qëndrueshëm ekonomik nëpërmjet promovimit të konceptit, ideve dhe veprimeve konkrete që mundësojnë rritjen e ndikimit të CSR-it në shoqërinë kosovare, qoftë në fushën e të drejtave të njeriut, punësimit të drejtë, mbrojtjen e mjedisit, apo çështje të ndryshme të karakterit social. “Ne jemi anëtarë dhe Organizatë Partnere për Kosovë e CSR Europë dhe punojmë në shpërndarjen e filozofisë të CSR-së në Kosovë, në mënyrë që kompanitë/organizatat kosovare të ndërmarrin aktivitete të përgjegjshme ndaj shoqërisë, t’i integrojnë çështjet sociale, ambientaliste dhe etike në operacionet e tyre biznesore dhe strategjike”, ka bërë të ditur ajo. Sipas saj, rrjeti CSR Kosova ka 19 anëtarë dhe është organizatë në rritje. “Ne mirëpresim edhe kompani të tjera, aktivitete të cilave kanë ndikim pozitiv në shoqërinë ku veprojnë dhe, të cilat nuk fokusohen vetëm në përfitimet e tyre ekonomike por janë të gat-

shëm të bëjnë diçka vullnetare për të adresuar përgjegjësinë ndaj shoqërisë”, ka theksuar Tahiri-Rukiqi.

AKTIVITETET E PËRGJEGJSHMENDAJ SHOQËRISË

Duke folur për investimet që i bëjnë anëtarët e CSR Kosova në komunitet, Tahiri-Rukiqi ka thënë se anëtarët e tyre i respektojnë të paktën parimet bazë të CSR-së, një kusht ky për t’u anëtarësuar dhe ndërmarrin aktivitete të përgjegjshme ndaj shoqërisë mbi supozimin që duhet të bëhet diçka vullnetare për të adresuar përgjegjësinë ndaj shoqërisë, gjë që shkon përtej detyrimit për të qenë në pajtueshmëri me ligjet dhe rregullativat e caktuara. “Ne kemi identifikuar edhe kompani të tjera që ndërmarrin aktivitete të CSR-së, me të cilat jemi në kontakt për anëtarësimin në mënyrë që bashkërisht të ndërmarrim veprime të përgjegjshme për ndikim më të madh dhe punojmë drejt objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Por, kompanitë tona anëtare dhe anëtarët potencial, përbejnë një numër të vogël të kompanive dhe mbetet për t’u dëshiruar që më shumë kompani të përqafojnë filozofinë e CSR-së. Rritja e ndikimit të CSR-së në shoqërinë kosovare e ndihmon adresimin e shumë sfidave që ka kjo shoqëri”. Drejtoresha e “CSR Kosova” thotë se ka rritje të interesimit të kompanive vendore për t’u bërë pjesë e këtij rrjeti, pasi që, siç thotë

ajo, viteve të fundit bizneset janë vetëdijësuar për rëndësinë e përgjegjësisë shoqërore në komunitetin ku operojnë, dhe po e shohin se investime të tilla nuk janë humbje as për ata, por një investim shumë afatgjatë. “Zbatimi i parimeve të CSR-it ka vlerë të jashtëzakonshme për një shoqëri dhe mjedisin biznesor të vendit ku veprojnë, por kjo i kthehet në të mirë edhe kompanive pasi që vlera e shtuar në mes të zbatimit të parimeve të CSR-së e rritë edhe reputacionin e kompanisë dhe ndikon pozitivisht në performancën e saj në përgjithësi”, thotë ajo.

TË NDIQET SHEMBULLI I BANKAVE

Tahiri-Rukiqi ka theksuar se sektori bankar i Kosovës është një prej sektorëve ku më së shumti zbatohen parimet bazë të CSR-së, dhe fatmirësisht, siç thotë ajo, kanë marr know-how nga kompanitë amë. “Raiffeisen Bank në Kosovë ka qenë ndër kompanitë e para që ka caktuar prioritetet e saj se si mund të kontribuojnë më së miri drejt realizimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) të Agjendës 2030 të OKB, dhe aktivitete të tyre të CSR-së ndikojnë në ato prioritetet. Gjithashtu, nga bankat komerciale, ProCredit Bank ka ndërmarrë një sërë veprimesh të CSR-së, përfshirë investimin e tyre në kapacitete të reja të teknologjisë dhe infrastrukture, të cilat ndikojnë në zhvillim të qëndrueshëm”, ka thënë ajo, duke shtuar se bizneset tjera patjetër



Linda Tahiri-Rukiqi, drejtoreshë ekzekutive e Rrjetit për Përgjegjësi Shoqërore Korporative (CSR Kosova), ka thënë se sektori bankar i Kosovës është njëri prej sektorëve ku më së shumti zbatohen parimet bazë të përgjegjësive korporative

që duhet ta ndjekin shembullin, dhe CSR është mekanizëm i rëndësishëm që shoqëria të adresojë sfidat e shumta që i kemi. Fatmirësisht, përveç bankave, biznese të tjera anëtare, vendore apo me kapital të huaj, janë gjithashtu shembull për praktikën e CSR-së.

Sipas saj, projektet e rrjetit “CSR Kosova” janë të financuara kryesisht nga vet anëtarët tanë, dhe pjesërisht nga donatorë të ndryshëm si bashkëfinancim. “Ne mbështesim anëtarët në integrimin e çështjeve etike, ambientaliste dhe ndërmarrjen e veprimeve me ndikim pozitiv në shoqërinë dhe komunitetin ku veprojnë. Dhe, gjithashtu kemi aktivitete të përbashkëta me të gjithë anëtarët, ku fokus primar kemi fuqizimin e rinisë, kryesisht nëpërmjet projektit tonë të përbashkët Pact4Youth (Pakti për rininë), i cili është lansuar edhe në organizata partnere të CSR-së nëpër Evropë (nismë e CSR Europe), dhe ka qëllim kryesor lidhshmërinë në mes të arsimit dhe kërkesave të tregut të punës”.

Në frymën e përkrahjes së rinisë, gjatë gjysmës së dytë të vitit 2018, CSR Kosova ka filluar bashkëpunimin me UNICEF-in për mbështetjen e rinisë në Kosovë, nëpërmjet fuqisë së sektorit privat, në kuadër të të cilit bashkëpunim janë mbajtur tryeza/punëtori me bizneset kosovare për shkëmbim të ideve dhe ndërtim të kapaciteteve drejt mënyrave se si mund të mbështetet rinia, përfshirë financimin e StartUps apo nëpërmjet vullnetarizmit. Dhe, ka projekte të tjera që

anëtarët tanë ndërmarrin e që ka të bëjnë me fuqizimin e rinisë, përfshirë këtu edhe trajnimin e rinisë së papune, dhe mbështetjen e personave me nevoja të veçanta. “Nga viti 2018 ne kemi organizuar edhe punëtori për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) të Agjendës 2030 të OKB-së, në mënyrë që anëtarët tanë të përcaktojnë prioritetet ku duhet të fokusohen që me së miri të ndikojnë në të mirë të shoqërisë dhe në zhvillim të qëndrueshëm. Disa anëtarë veç kanë arritur të përcaktojnë prioritetet e tyre, dhe të tjerët po punojnë në këtë drejtim”.

INVESTIMET E BANKAVENË QKUK

Bankat komerciale të Kosovës kanë bërë disa investime në reparteve të ndryshme të Qendrës Klinike dhe Universitare të Kosovës (QKUK). Zyrtarë për informim nga QKUK-ja thonë se ka pasur disa donacione të bankave që kryesisht kanë qenë të lidhura me shëndetin e nënës dhe fëmijëve. “Një bankë vendore ka investuar edhe në rinovim të disa reparteve në Klinikën e Pediatri-së. Për momentin nuk kemi ndonjë shifër të saktë dhe po ashtu nuk mund t’i cekim bankat me emër”, kanë pohuar zyrtarët e QKUK-së.

Në vitin 2014, Banka Raiffeisen kishte dhuruar një donacion në vlerë prej 100,000 euro për QKUK-në, përderisa donacioni përmbante shtrëtarë dhe pajisje tjera të nevojshme për Klinikën Obstetrike Gjinekologjike në kuadër të QKUK-së.

Në kuadër të përgjegjësive sociale, Banka

Ekonomike ka vazhduar të përkrahë fëmijët duke dhuruar donacion për QKUK-në, respektivisht Klinikën e Pediatri-së, repartin e Hematologjisë-Onkologjisë. “Sistemi shëndetësor, në veçanti shëndeti i fëmijës vazhdon të jetë sfidë e madhe e shoqërisë tonë. Prandaj, duke pasur parasysh që fëmijët janë gurë themel i një kombi e shoqërie, Banka Ekonomike ka vendosur që ta dhurojë këtë donacion për QKUK-në. Ndonëse një kontribut modest, megjithatë përmes këtij donacioni ne kemi synuar të furnizojmë me inventar të ri dhe po ashtu të përmirësojmë ambientin e punës me qëllim që të ofrohen kushte sa më të mira për punë, dhe kështu të trasojmë një të ardhme të sigurtë për fëmijët”, kanë thënë drejtuesit e bankës.

DONACIONI PËR SHTËPINË E TË MOSHUARVE

Në fund të vitit 2017, banka NLB kishte dhënë donacion për përmirësimin e kushteve të banimit në Shtëpinë e të Moshuarve në Prishtinë. Me këtë donacion ishte blerë inventar për 70 banorë të kësaj shtëpie si dhe janë përmirësuar shumë pjesë tjera të shtëpisë.

“Kontributi i NLB-së do të vazhdojë edhe në të ardhmen në mbështetje të aktiviteteve dhe projekteve të rëndësishme ekonomike, humanitare, sociale e kulturore, të cilat kontribuojnë direkt në zhvillimin, lehtësimin dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve të Kosovës”, patën thënë drejtuesit e kësaj banke komerciale.



Mbi 1.2 miliardë euro kredi të reja

Rënia e vazhdueshme e normës së interesit të kredive ka ndikuar në rritjen e përsheptuar të volumit të kredive të aprovuara nga bankat komerciale që operojnë në Kosovë. Hiç më pak se 1 miliardë e 237 milionë euro ka arritur vlere të kredive të reja që janë lejuar nga bankat, nga janari e deri në fund të nëntorit të vitit që e lamë pas. Sipas të dhënave të siguruar nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), shihet se në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kemi një rritje të kredive të reja për 78 milionë euro. Sipas këtyre të dhënave shihet se gjatë muajit nëntor të vitit 2018 shuma e kredive të lejuara nga bankat ka arritur në 116.6 milionë euro, apo 7.2 milionë euro më shumë se sa në muajin e njëjtë të vitit që lamë pas. Sipas të dhënave të BQK-së shihet se qershori ka qenë muaji më i suksesshëm, në të cilin rekordi i kredive ka arritur në 138.4 milionë euro. “Gjatë muajit

janar 2018, bankat kanë lejuar kredi në vlerë prej 96.7 milionë euro, gjatë muajit shkurt 90.5 milionë euro, në mars 126.4 milionë euro, gjatë muajit prill 119.4 milionë euro, gjatë majit 136.2 milionë euro, gjatë muajit qershor 138.4 milionë euro, gjatë muajit korrik 106.7 milionë euro, gjatë muajit gusht 110 milionë euro, gjatë shtatorit 78.2 milionë euro, gjatë muajit tetor 118.4 milionë euro, si dhe gjatë muajit nëntor të vitit 2018 kreditë e lejuara kanë arritur në vlerën 116.6 milionë euro”, thuhet në raportin e fundit të Bankës Qendrore të Kosovës.

Derisa gjatë janarit të vitit 2017 vlere të kredive të reja të lejuara nga bankat kishte arritur në 54.5 milionë euro, në shkurt 90.9, në mars 128.1, në prill 106.9, në maj 120.8, në qershor 123.1, në korrik 111.8, në gusht 92.6, në shtator 78.2, në tetor 118.4 si dhe në nëntor 116.6.

SIPAS TË DHËNAVE TË BQK-SË SHIHET SE QERSHORI KA QENË MUAJI MË I SUKSESSHËM, NË TË CILIN REKORDI I KREDIVE KA ARRITUR NË 138.4 MILIONË EURO

Kreditë e reja të lejuara në periudhën janar-nëntor 2018:

	2018	2017	Diferenca
Janar	96,7	54,5	+42,2
Shkurt	90,5	90,9	-0,4
Mars	126,4	128,1	-1,7
Prill	119,4	106,9	+12,5
Maj	136,2	120,8	+15,4
Qershor	138,4	123,1	+15,3
Korrik	106,7	111,8	-5,1
Gusht	110,0	92,6	+17,4
Shtator	78,2	101,6	-23,4
Tetor	118,4	119,6	-1,2
Nëntor	116,6	109,4	+7,2
	1,237	1,159	+78,0



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

Shoqata e Bankave të Kosovës ndanë 25,000 euro për familjen e policit që humbi jetën në mbrojtje të qytetarëve në Istog

Shoqata e Bankave të Kosovës ka marrë vendim t'i ndajë 25,000 euro ndihmë financiare për familjen e policit Izet Demaj, i cili humbi jetën në krye të detyrës për të mbrojtur lirinë e gjithë qytetarëve të Kosovës dhe të drejtën e tyre për të jetuar dhe vepruar të qetë dhe të sigurtë në Republikën e Kosovës.

Shoqata e Bankave të Kosovës duke i shprehur ngushëllimet më të sinqerta familjes së policit Izet Demaj ka njoftuar se ka marrë vendim për të ndarë një ndihmë prej 25,000 euro për këtë

familje. Përveç ndihmës monetare aktuale, vendimi i Shoqatës së Bankave parasheh edhe ndihma të tjera për të qenë pranë familjes Demaj edhe në të ardhmen për të ndihmuar këtë familje sado pak në këto rrethana të vështira në të cilat po kalojnë ata.

Në mesazhin e ngushëllimit nga Shoqata e Bankave të Kosovës në mes tjerash thuhet: "Polici Demaj dha jetën e tij për të mbrojtur lirinë e gjithë qytetarëve të Kosovës dhe të drejtën e tyre për të jetuar dhe vepruar të qetë dhe të sig-

urte në Republikën e Kosovës. Izet Demaj nuk u pajtua me te keqen dhe ra heroikisht për një të ardhme më të sigurtë për të gjithë qytetarët e Kosovës."

Shoqata e Bankave të Kosovës dënon fuqishëm veprimet e tilla kriminale siç është grabitja e një banke, veprime të cilat janë bërë dukuri e shëmtuar në vitet e fundit në Kosovë dhe njëherësh shpreh mbështetje për institucionet e sigurisë për të rritur kapacitetet dhe angazhimet në parandalimin e këtyre incidenteve.



Bordi i Drejtorëve të Shoqatës së bankave të Kosovës mban takimin e fundvitit

Bordi i Drejtorëve i Shoqatës së Bankave të Kosovës (SHBK) ka mbajtur takimin e fundvitit, ku janë diskutuar të arriturat për vitin 2018 dhe janë bërë planifikimet për vitin e ardhshëm.

Bordi i Drejtorëve ka vlerësuar lartë punën e SHBK-së në përfaqësimin e sektorit bankar dhe përmirësimin e ambientit të të bërit biznes. Përveç të arriturave u identifikuan edhe shumë sfida për të

cilat anëtarët u zotuan që do të punojnë së bashku, në mënyrë që sektori bankar të zhvillohet dhe zgjerohet në funksion të rritjes së qasjes në financa dhe zhvillimit ekonomik të Kosovës.



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

Kjo shtojcë mbështetet nga Shoqata e Bankave të Kosovës